DALJE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. 020-365/1
Data 05.04.2019

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| **Për:** | **Bashkim Ramosaj,** Kryetar i Komunës së Deçanit<br>**Haki Shehaj,** Kryesues i Kuvendit të Komunës së Deçanit | |
| **Cc:** | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| **Përmes:** | **Ivan Todosijević, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal**<br>**Rozafa Ukimeraj,** Sekretare e Përgjithshme | |
| **Nga:** | **Venera Çerkini,** U.D. Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave | Datë: 04/04/2019<br>Nr.020-365 |
| **Lënda:** | Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Deçanit | |
| **Lloji i aktit:** | Vendim i Kuvendit të Komunës | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendim 01.Nr.III-2 mbi bashkëpunimin ndërkomunal me Komunën e Pejës |
| I miratuar më datë: 03/04/2019 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 04/04/2019 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **<u>është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi</u>** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

DALJSE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-365/1
-VI-
Data Datum Date 05.04.2019

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| **Za:** | **Bashkim Ramosaj,** gradonačelnik Opštine Dečan<br>**Haki Shehaj,** predsedavjući Skupštine opštine Dečan | |
| **Cc:** | Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u<br>Jedinici za administraciju dokumenata u opštini | |
| **Preko:** | **Ivan Todosijhević,** ministar MALS-a,<br>**Rozafa Ukimeraj,** generalna sekretarka MALS-a, | |
| **Od:** | **Venera Çerkini,** v.d. rukvodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS | Datum, 04.04.2019.<br>Br.020-365 |
| **Predmet:** | Potvrda zakonitosti akta opštine Dečan | |
| **Vrsta akta:** | Odluka Skupštine opštine Dečan | |

Uvaženi gradonačleniče,
Uvaženi predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativo razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razamatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

| |
|---|
| Odluka 01.br.III-2 o međuopštinskoj saradnji sa opštinom Peć |
| Usvojena dana, 03/04/2019. godine |
| Predložena za razmatranje u MALS-u dana 04/04.2019. godine |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinki akt **u saglasnosti sa zakonskim odrebama zakonodavstva na snazi** i kao takav može proizvesti pravni učinak.

Ministartsvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.

Në pajtim me nenin 12 pika d), nenin 28 dhe nenit 40 pika j) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në zbatim të nenit 7 të Ligjit nr. 04/L-010 për Bashkëpunimin Ndër komunal, si dhe nenit 25 pika 22 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit, në mbledhjen e mbajtur me dt.03.04.2019, miraton këtë:

# VENDIM

## MBI BASHKËPUNIMIN NDËRKOMUNAL ME KOMUNËN E PEJËS

1. Miratohet nisma e Kryetarit të Komunës së Deçanit për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal me Komunën e Pejës.

2. Bashkëpunimi ndër komunal do të zhvillohet mes Komunës së Deçanit dhe Komunës së Pejës, në fushën e zhvillimit të infrastrukturës Ndër komunale, projekti: "Ndërtimi i urës mbi lumin Lumbardh që lidhë fshatratë Vranoci i Vogël-Vranoci i Madh dhe trasimi i rrugës Vranoc i Vogël-Lumbardh".

3. Qëllimi i bashkëpunimit është realizimi i projektit të infrastrukturës ndër komunale"Ndërtimi i urës mbi lumin Lumbardh që lidhë fshatratë Vranoci i Vogël-Vranoci i Madh dhe trasimi i rrugës Vranoc i Vogël-Lumbardh".

4. Ky project i infrastrukturës do të zbatohet me mbështetjen e Fondit të Bashkëpunimit Ndër komunal 2019, bazuar në Thirrjen për aplikime për financimin e projekteve për bashkëpunimin ndërkomunal MAPL 454-197, datë 27.02.2019.

5. Autorizohet kryetari i komunës për të filluar konsultimet me komunën e Pejës për përgatitjen e propozim marrëveshjes për bashkëpunim ndër komunal.

6. Ky akt hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës së Deçanit.

01. Nr.III-2
Deçan,dt.03.04.2019

Kryesuesi i Kuvendit
Hysni Shehaj